



# NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NIXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDRËVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NIXTUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#112

## TAKIMI/ Dita Ndërkombëtare e Remitancave, ndikimi në zhvillimin ekonomik



Në Ditën Ndërkombëtare të Remitancave, Agjencia Kombëtare e Diasporës, me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Bankës së Shqipërisë zhvilloi aktivitetin “Dita Ndërkombëtare e Remitancave”, duke vlerësuar kështu këtë kontribut të remitancave në dobi të familjeve të vendit si dhe formalizimin e kanaleve të dërgimit të tyre në atdhe, objektiva kryesore këto dhe të Strategjisë Kombëtare të Diasporës.

Diskutimi u zhvillua në dy panele: “Remitancat, ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit” dhe “Identifikimi dhe promovimi i politikave, programeve dhe praktikave më të mira të institucioneve financiare në lidhje me forcimin e kontributit të emigrantëve”.



## "Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tashmë kanë mundësi të aplikojnë për rinovimim e dokumentave të tyre biometrike, si dhe të deklarojnë adresën e tyre të vendbanimit online.

## DITA E REMITANCAVE/ Ministri Majko: Të krijojmë model për ti dhënë hov zhvillimit ekonomik

Në takimin në Ditën Ndërkombëtare të Remitancave, mbajti fjalën e tij dhe ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko. Ai tha se deri tani remitanca është konsideruar vetëm një e ardhur dhe kaq, duke theksuar nevojën e një modeli të dobishëm, një alfabeti të ri ekonomik, pasi remitancat tejkalojnë dhe investimet e huaja në vend.

“Mendoj që takimi i sotëm është i një rëndësie të veçantë. Arsyetimi mbështetjen tek Strategjia Kombëtare e Diasporës, është në një moment të rëndësishëm të aplikimit të vet. Është ndër sektorët e rrallë të Republikës së Shqipërisë që brenda 4 viteve është strategjia e dytë që aplikohet për diasporën dhe marrëdhëniet e shtetit shqiptar me Diasporën. Ajo që dëshiroj të nënvizoj është tema e remitancave që deri tani është konsideruar si një e ardhur dhe vetëm kaq. Modellet e dobishme që po shohim në shumë vende të botës tregojnë se bëhet fjalë për një alfabet të ri ekonomik kur flitet për remitancat.



Është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionet e ndryshme në Diasporë

## QBD/ Mbahet takimi i radhës i Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën



U mbajt në mjediset e QBD mbledhja e radhës e Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Këshillit, drejtori i Bibliotekës Kombëtare z. Piro Misha, anëtarët e Këshillit: prof. Floresha Dado, përfaqësuese e Akademisë së Shkencave; znj. Mira Hoxha, përfaqësuese e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme; znj. Anila Ferizaj, përfaqësuese e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe znj. Ada Ilija, Drejtore e Kabinetit të Ministrit të Shtetit për Diasporën.

Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën diskutoi mbi mbarëvajtjen e mësimin të gjuhës dhe kulturës shqiptare në Diasporë, nevojat dhe kërkesat që kanë shkollat lidhur me mësimdhënien dhe miratoi në parim listën e teksteve shkollore për mësimin plotësues në Diasporë për vitin shkollor 2021-2022.



Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjeve si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

## VIZITA/ “Në Kalabri me Arbëreshët”, QSPA në 5-vjetorin e universitetit “Nënë Tereza”

Drejtoresha Ekzekutive e QSPA, Diana Kastrati ka zhvilluar një vizitë në Maqedoninë e Veriut, e ftuar për të marrë pjesë në aktivitetet në kuadër të 5-vjetorit të themelimit të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup ku ka prezantuar 6 botime të realizuara nga anëtarët e stafit akademik të universitetit, mes të cilëve edhe librin e studiuesit prof. dr. Mustafa Ibrahim, me titull: “Në Kalabri me Arbëreshët”. Një botim i përbërë nga 23 reportazhe të realizuara nga autori në vendbanimet e arbëreshëve në Italinë e Jugut.

Në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, drejtoresha e QSPA së bashku me drejtuesin z. Skënder Hasani, nënshkroi marrëveshjen dypalëshe. Drejtuesit të dy institucioneve, u zotuan se ky memorandum bashkëpunimi do të jetë jo vetëm formal, por edhe përmbajtësor, me aktivitete e projekte konkrete që do të realizohen bashkërisht në të ardhmen.



## Digjitalizimi i Veprave Shqiptare

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

## MARRËVESHJA/ QSPA bashkëpunim me Agjencinë e Zbatimit të Gjuhëve në Maqedoninë e Veriut



Në vazhdim të takimeve në Shkup, Drejtoresha Ekzekutive e QSPA Prof. Diana Kastrati ka realizuar nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me z. Ylber Sela – drejtor i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhëve (AZGJ). E ftuar të marrë pjesë në aktivitetet që po mbahen me rastin e 5-vjetorit të themelimit të Universitetit “Nënë Tereza” të Shkupit, Drejtoresha Kastrati është prituar nga pjesa me e madhe e institucioneve kërkimore-shkencore në kryeqytetin e Maqedonisë së Veriut. Në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës, institucionin i pavarur kushtetues, Drejtoresha Kastrati e shoqëruar nga bashkëpunëtorët Dr. Vilma Proko dhe Dr. Edmond Cane, u pritën nga vetë drejtori Ylber Sela. Gjatë këtij takimi u fol për këto dy institucione, për gjendjen e gjuhës shqipe dhe, sidomos, për arbëreshët dhe arbërishten. Me këtë rast Drejtoresha Kastrati i dhuroi AZGJ-së disa botime të qendrës së saj, të autorëve Jup Kastrati, Antonio Bellushi dhe Ornella Radovicka, Klara Kodra, si dhe Silvana Nini.

## Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store: këtu Play store: këtu